



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. Prot. 2202/\_\_\_

Data \_\_\_/\_\_\_/2023

### **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i prokurimit:** “Ndertimi i godinës së re të laboratorëve në ISHP”

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):** 45210000-2, Punime ndërtimi.

**Vlera e fondit limit:** 384,988,709.39 (treqind e tetëdhjetë e katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntë .39) **Lekë pa TVSH:**

Në bazë të pikës 2 të Nenit 21 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, MSHMS në cilësinë e Autoritetit Kontraktor/organit të cilit i është deleguar e drejta e kryerjes së procedurës së prokurimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, si dhe kriterin e vlerësimit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Afati i ekzekutimit të kontratës:** 16(gjashtëmbëdhjetë) muaj nga njoftimi për fillimin e punimeve (sipas grafikut të punimeve të dhënë nga projektuesi)

#### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1
- c. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të procedurës për të cilën konkurron.** (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/b dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa e mesiperme i shërben Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetet financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në *nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur **të procedurës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose,
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit **të procedurës** që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben ofertën të kualifikueshme.**

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

**Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.** Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë **të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.**

Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit **në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.**

**2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me **ente publike**, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikaten e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.
  
- b) Për kontrata të realizuara me **sektorin privat**, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
  - Fatura tatimore përkatëse.

**SHENIM:**

*Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:*

- *Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku tregohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim dhe elementët që ka marre përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit të deklaruar në fazën e tenderimit.*

*Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:*

- *Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor (në rast se ka qenë e përcaktuar në kontratë miratimi).*

**Argumentimi:** Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të **procedurës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose,
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të **procedurës** që prokurohet.

Plotesimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me

*aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 2.3.2 a dhe b, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.” .

**2.3.3** Bazuar në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

## **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :**

- **N.P - 1 A** Punime gërmimi në tokë;

*Argumentimi* Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

- **N.P - 2 C** Ndertime civile e industriale

*Argumentimi* Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtëpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

- **N.P - 7 A** Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje;

*Argumentimi* Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçantasi edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mire të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantetetrajtimittëujittë pishëm, ujësjellsat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

- **N.P – 11 A** Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

*Argumentimi* Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

## **Për punimet speciale të ndërtimit :**

- **N.S - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve

*Argumentimi* Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave



*betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

- **N.S - 2 B** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;

*Argumentimi* Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

- **N.S - 3 A** Impiante ngritëse dhe transportuese

*Argumentimi* Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues) Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme

- **N.S - 4 C** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;

*Argumentimi* Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

- **N.S - 12 C** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;

*Argumentimi* Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

- **N.S - 14 C** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

*Argumentimi* Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

**Nisur nga zerat e preventivit, vlera e licencave per cdo kategori jane ne përmbledhësen sa më poshtë vijon në lekë pa TVSH:**

NP-1	9,657,098.72	<b>A</b>
NP-2	90,464,957.29	<b>C</b>
NP-7	2,376,768.26	<b>A</b>
NP-11	15,067,114.32	<b>A</b>
NS-1	1,184,500.00	<b>A</b>
NS-2	26,475,585.21	<b>B</b>
NS-3	6,905,785.50	<b>A</b>
NS-4	99,728,375.06	<b>C</b>
NS-12	80,183,363.09	<b>C</b>



NS-14	52,945,161.95	C
-------	---------------	---

**Argumentimi:** Kushtimi ne leke eshte vendosur bazuar ne:

LIDHJA 4 te VKM nr.42 KLASIFIKIMI PARAPRAK I SHOQËRIVE NDËRTIMORE SIPAS NIVELEVE PËR ÇDO KATEGORI PUNIMESH ZBATIMI

**niveli i shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi**

A (edhe për herë të parë) 0- 20 milion lekë

B 21- 50 milion lekë

C 51 – 100 milion lekë

D 101 – 200 milion lekë

E 201 – 400 milion lekë

F 401 – 800 milion lekë

G mbi 800 milion lekë

2.3.4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të deklarojnë drejtuesit teknik për këtë vepër, të punësuar për periudhën e kërkuar, **Maj 2023**, të cilët duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt sipas grafikut të punimeve të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV:

- Inxhinier Ndërtimi
- Inxhinier Mekanik
- Inxhinier H/teknik
- Inxhinier Elektrik

*(Në rastin e Bashkimit te Operatoreve ekonomik, sipas punimeve që merr përsipër të realizojë referuar Preventivit të punimeve, secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt, të cilët duhet të jetë të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera dhe të jenë te pranishem gjatë gjithë kohës qe do të kryhen punimet në objekt).*

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te DST.**

**Shenim:** Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

**Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Bazuar ne **UKM nr.2 date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”**, pika 1.2 Drejtuesit ligjorë dhe teknikë të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu bazuar ne po kete udhezim Pika 4.1 Drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier. Nisur nga fakti qe kemi kerkuar licencat e shoqerise sipas pikes 2.3.3/1, atehere keto licenca kane detyrim drejtuesin teknik te firmes sipas specialitetit perkates.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar-drejtues teknike është përcaktuar në vijim te Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar drejtues teknike sipas pikës 2.3.5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP1, NP3, NS1, NS4**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP7, NS2, NS12** është e nevojshme prezenca e **një Inxhinier Hidroteknik dhe nje inxhinieri mekanik**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS 14** është e nevojshme prezenca e **Inxhinier Elektrik**.

2.3.5 Shoqërite ofertuese, duhet të prezantojnë se kanë në stafin e tyre (ose drejtues Teknik, ose inxhinier jo drejtues Teknik, ose të kontraktuar vetëm për këtë procedurë)

- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)

**Argumentimi:** Nisur nga fakti qe per investimin kemi prishje dhe ndërtim godine, është e nevojshme kryerja e rilevimit topografik, i cili realizohet nga inxhinieri topograf/gjeodet/markshajder.

2.3.6. Operatorët ekonomik pjesëmarrës, për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi (jo -drejtues teknike), kërkohet që të deklarojnë **Përgjegjësin teknik të kantierit** i cili duhet të jetë:

- a) **1(një) Inxhinier ndërtimi** me eksperience minimalisht 3 vite në zbatim

Për përgjegjësin e kantierit sipas pikës 2.3.6 duhet të paraqitet:

- kontrata e punës të vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve, &
- diploma &
- CV.
- Shënim: Në CV të paraqiten kontratat që ka zbatuar, me qëllim verifikimin e eksperiencës së punës.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te DST.**

*Shënim:*

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “***Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në***

shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

**Argumentimi:** Bazuar ne UKM nr.2 date 13.05.2005 “per zbatimin e punimeve te ndertimit”, Pika 4.1 Drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier.

Bazuar ne UKM nr.2 date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,

### **Kreu I – SIPERMARRESI I PUNIMEVE TE NDERTIMIT**

2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose **përgjegjësi teknik i kantierit**.

Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, **përgjegjësi teknik i kantierit** është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

### **Kreu II- ZBATIMI I PUNIMEVE TE NDERTIMIT**

1.1 **Përgjegjësi teknik i kantierit** merr në dorëzim, me procesverbal të rregullt nga subjekti projektues, hartat/relievet topografike, pikat e referimit topogjeodezik (reperët), që sigurojnë lidhjen e objektit me terrenin. Ato ruhen deri në përfundim të kolaudimit të punimeve.

2. **Përgjegjësi teknik i kantierit** verifikon saktësinë e lidhjes së objektit me terrenin dhe të piketimit të tij. Ai është përgjegjës për zbatimin e përpiktë të projektit, sipas vizatimeve, përshkrimeve teknike e ndryshimeve të miratuara prej tyre, në përputhje me kërkesat e kushteve teknike të zbatimit, në fuqi, me specifikimet teknike të kontratës dhe sipas radhës teknologjike të punimeve.

6.2 **Përgjegjësi teknik i kantierit** ka këto të drejta dhe detyra:

- a) Të instruktojë dhe riinstruktojë të gjithë punonjësit, çdo fillim muaji, në përputhje me programin mujor të punës;
- b) Të instruktojë, veçanërisht, punonjësit e rinj, që fillojnë punë për herë të parë, skuadrat e individëve, që vijnë rishtaz në kantier, që fillojnë një proces të ri pune apo që vendosen në punime të veçanta me shkallë vështirësie;
- c) Të largojë menjëherë nga puna çdo punëmarrës, që nuk zbaton masat e sigurimit teknik e të mbrojtjes në punë, si dhe të pezullojë punën kur nuk garantohen masat mbrojtëse;
- ç) Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe të mekanizmave nga manovratorë të paafhtë;
- d) Të hartojë aktin e marrjes në dorëzim të skelave të jashtme. ETJ

2.3.7. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të punësuar per periudhën **Maj 2023** si më poshtë :

- Teknik Ndërtimi	min 2 (dy)
- Hidraulikë	min 3 tre
- Elektricitë/electroteknik	min 4 (kater)
- Mekanike/ elektromekanik	min 2(dy)
- Instalues te ashensoreve	min 2 (dy)
- Instalues te sistemeve ftohëse-ngrohëse	min 2 (dy)
- Përgatitës të konstruksioneve metalike	min 2 (dy)
- Hekurkthyes	min 2 (dy)
- Karpentier	min 2 (dy)
- Saldator dhe prerës të metaleve	min 2 (dy)
- Hidroizolues	min 2 (dy)
- Muratore	min 3 (tre)
- Suvatues	min 3 (tre)
- Pllakashtrues	min 2 (dy)
- Specialist gipsi	min 2 (dy)
- Bojaxhi	min 2 (dy)
- Punonjës dur-alumini	min 2(dy)
- punetor montimi dyer,dritare	min 3 (tre)
- betonues	min 2 (dy)
- punonjes finiture ne ndertim	min 2(dy)

2.3.7 a. Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, pervec atyre qe rregullohen sipas pikes 2.3.7 b., ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*”.

2.3.7 b. Për punonjësit:

Elektricitë/elektroteknik,  
Instalues të sistemeve ftohëse-ngrohëse,  
Instalues të ashensorëve,  
Mekanike/elektromekanik,  
Saldatore dhe prerës të metaleve,  
të paraqitet:

- kontratën individuale të punës;
- dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** *Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.*

*Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik.*

*Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional.*

*Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.



2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 85 persona** (përfshire dhe stafin drejtues teknik dhe stafin me certifikate IQT ose e barazvlefshme dhe me dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), të vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhen **Maj 2023**
- b. List - pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhen **Maj 2023**

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8 të DST.**

**Shenim:** Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

### **Argumentimi:**

Nga ana teknike argumentojmë se fuqia punëtore prej minimalisht 85 persona, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimin të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 16 muajve nga marrja e lejes së ndërtimit, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohej që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpërndarje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

*Nëpërmjet këtij kushti kërkohej që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpërndarje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme*

Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te DST.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<b>NR.</b>	<b>MJETET</b>	<b>SASIA</b>
1	<u>Kamion per furnizimin me materiale dhe largimin e mbeturinave nga objekti me kapacitet mbajtes minimumi 14 ton (vete shkarkues)</u>	<u>Min 2 cope</u>
2	<u>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 10 ton</u>	<u>Min 2 cope</u>
3	<u>Kamioncine me kapacitet mbajtes min 4 ton</u>	<u>Min 3 cope</u>
4	<u>Ekskavator goma 0.15 m³</u>	<u>Min 1 cope</u>
5	<u>Fadrome</u>	<u>Min 1 cope</u>
6	<u>Autobetoniere</u>	<u>Min 1 cope</u>
7	<u>Pompe betoni ose autopompe betoni</u>	<u>Min 1 cope</u>
8	<u>Gjenerator ose motogjenerator</u>	<u>Min 1 cope</u>
9	<u>Elektro betoniera ose moto betoniera per pergatitje betoni dhe llaci ne object me kapacitet te betonieres 0.3 -0.5 m3</u>	<u>Min 3 cope</u>
10	<u>Pompe uji</u>	<u>Min 1 cope</u>
11	<u>Moto saldatrice/saldatrice/elektrosaldatrice</u>	<u>Min 1 cope</u>
12	<u>Vibrator betoni</u>	<u>Min 2 cope</u>
13	<u>Depozite uji min 5000 lt</u>	<u>Min 1 cope</u>
14	<u>Mates energjie</u>	<u>Min 1 cope</u>

15	Autovinç me kapacitet ngrites min. 5 ton	<u>Min 1 cope</u>
16	<u>Vinc karel (portativ) i levizshem me kapacitet 0.3 ÷0.5 ton</u>	<u>Min 1 cope</u>
17	<u>Matrapik</u>	<u>Min 2 cope</u>
18	<u>Prerese pllakash</u>	<u>Min 3 cope</u>
19	<u>Prerese hekuri</u>	<u>Min 2 cope</u>

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.**

- Për mjetet, nëse janë në pronësi duhet të paraqiten faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.
- Për mjetet, nëse janë me qera, duhet të paraqiten kontratat e qerave ku afati i marrjes me qera të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit dhe faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë në pronësi, duhet paraqitur dokumenti që vërteton **regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor.**
- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë me qera, duhet paraqitur dokumenti që vërteton **regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor, dhe kontrata e qerasë e cila duhet të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit.**

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës

dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

1. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 14 ton. Prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe zerave Transport i mbeturinave , rere zhavorri, cakëll etj.,
2. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton. Prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses duke bere te mundur transportin e materialeve per ndertim
3. Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 4 ton prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe per transportin e materjaleve te ndryshme te ndertimit, hidraulike elektrike etj ku mjet është i favorshen pasi mund te qarkulloj ne territor pa orar .
4. Ekskavator me goma 0.15m<sup>3</sup>- prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe zërin Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m<sup>3</sup>, ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke.
5. Fadromë -prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe eshte i nevojshem per prishje te godinave 1 katshe, per pastrime germime dhe afrimin e materjalit neper fronte pune .
6. Autovinç me kapacitet ngrites min 5 ton - prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe eshte per ngritjen e materjaleve sipas kerkesave dhe nevojave te projektit.
7. Autobetoniere - prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht trasportin e betonit nga nyja ne kantjer .
8. Elektrobetoniera- prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, pergatitjen e sasive te vogla te betonit, per te cilat nuk eshte e domosdoshme te presesh autobetonierat.
9. Pompe betoni/Autopompë betoni -prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht hedhje ne betonit nga autobetoniera ne objekt .
10. Pompë suvatimi- prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht per punimet e suvatimit.

11. Elektrosaldatrice/saldatrice/motosaldtrice - prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për saldimin e tubove dhe konstruksioneve metalik
12. Moto gjenerator ose gjenerator- prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo pajisje është e domosdoshme për sigurimin e energjisë elektrike në rastet e mungesës së saj.
13. Depozite uji (kapaciteti minimal 5000 litra) prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për punimet e betonit, suvatimit, etj.
14. Vibrator betoni prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht në momentin që do të hedhim beton në objekt
15. Vinç karel (Portativ) i levizshëm me kapacitet 0.3. – 0.5 ton - prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për ngritjen e hekurit, tullave, cimentos, materialeve të tjera.
16. Prerese pllakash – nisur nga fakti që një nga zerat e preventivat janë dhe shtresat e pllakave, ku detyrimisht duhet dhe kjo pajisje për prerjen e tyre sipas vendit.
17. Matrapik – perdoret për prishjet

### 2.3.10 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatat e cilësisë si më poshtë:

- a. Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c. Certifikatën **ISO 45001:2018** (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.8, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.11 Deklaratë e ofruesit për modelin, kompanin prodhuese, vendin e prodhimit për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme



Nr.	Emërtimi i pajisjes	Modeli	Prodhuesi	Vendi i prodhimit
1	Pajisje tensioni: HV24kV / 630A i mbyllur me tub metalik me transformatorë të rrymës dhe tensionit HV dhe ndërprerës, duke përfshirë kompletin e pranueshëm të matjes sipas OSHEE SM6 GBC-B 750			
2	Kondensatori Automatik - CB-01 (Automatic Capacitor Bank) tip SAH për rrjet trefazor 400V-50Hz, me kabinet IP30, IK10, dizajn plotësisht modular për zgjerim dhe mirëmbajtje të lehtë me ndërprerës automatik 630A / 36kA. Kontaktoret kontrollohen nga kontrolluesi i furnizimit me energji Alptec me një procedurë të thjeshtë vënie në punë. Kontrolli i hapave duke përdorur kontaktorë elektromekanikë CTX3 me rezistorë amortizues të përshtatshëm për kondensimin e rrymave. Bankat e kondensatorëve me ndërprerës: lidhje përmes majës. dollap me ngjyra RAL 7035. Në përputhje me standardin IEC 61921. Të dhënat kryesore teknike: Fuqia nominale: 225kVAr, Harmonikë të lartë THU ≤6%, THDI≤30% Hapa (kVAr) (25+50+2x75). “Karakteristikat e përgjithshme: • IP 30 - IK 10 kabinet ose mbyllje			
3	Njesi e jashtme Modulare VRF 1, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 45-50 kW, fuqia e instaluar 13.6kW, temperatura e punës -20/+46°C, EER=3.65 në ftohje, COP= 4.03 në ngrohje. Dimensionet: 1690x1240x765 mm, Pesha=275 kg			
4	Transformatori i fuqisë me rrëshirë të derdhur A0Ak seria 3ph-GREEN T.HE TIER 2, sistem izolimi me izolim natyral			

	<p>të klasës F (AN) për instalim të brendshëm, i destinuar për përdorim në sistemet e shpërndarjes trevjeçare TM/LV, me të dhëna dhe specifikime si më poshtë:</p> <p>Fuqia nominale = 1000 kVA  Tensioni primar (kV) = 20 kV  Tension dytësor pa ngarkesë = 400 V Uk(%) = 6% Po(W)=1395 W Pk(W) në 120oC = 9000W  Io(%) = 0.6 % LwA- fuqia akustike (dB (A)) = 65 db  Dimensionet: (1700x1000x1940) mm, Masa: 2900 kg  cilat përfshijnë: IEC 60076-1;-2;-3;-4;-5;-11;-12;-16; dhe EN 50588-1</p> <p>Transformatori duhet të prodhohet në përputhje me klasën mjedisore E3 dhe klasën klimatike C2 siç tregohet në pllakën e klasifikimit të transformatorit. Jo ndotës dhe të certifikuar në përputhje me ISO 9001 dhe ISO 14001. Të dyja janë të certifikuara nga një organizatë zyrtare e pavarur. Furnizuesi duhet të paraqesë udhëzimet gjatë gjithë jetës, deklaratën REACH dhe dokumentacionin e profilit mjedisor të produktit sipas kërkesës.</p>			
5	<p>Gjenerator dizel pa mbyllje "GP660SM/P, Fuqia kryesore 600kVA / 480kW, 230 / 400VAC, 50Hz, 0.8PF, 3 faza, 770 Hp, me ATS sipas specifikacionit teknik.</p>			
6	<p>Pompë e Nxehtësisë (Chiller-it), kapaciteti në ftohje/ngrohje: 335 kW/362 kW  Dim (HxWxL): 2220x2258x4125 mm</p>			
7	<p>Njesi e trajtimit të ajrit AHU 01 :  Konstruksioni perbëhet nga profil special alumini , i cili lidhet me qoshet e aluminit . Anët e</p>			

	<p>konstruksionit janë te mbyllura me panele izolimi termik dhe akustik . Në strukturë janë inkorporuar të gjitha elementet per trajtimin e ajrit . Prurja e ajrit Q= 13373 m<sup>3</sup>/h . Seksioni i rekuperimit 80 % me rryma te kunderta . Seksioni i filtrimit : Filter G4 ( Hyrje dhe Dalje) , Filter F7 ne hyrje . Bateri uji ftohje/ngrohje 40/48 kW. Presioni në dergim 350 Pa dhe kthim 350 Pa. Gjenerator avulli 86 kg/h(47 kW). Dimensionet 2700x1220x5680 mm . Montimi , testimi dhe dorëzimi sipas përshkrimit në projekt , specifikimeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesit.</p>			
8	<p>Njesi e trajtimit të ajrit AHU 02/04 : Konstruksioni perbëhet nga profil special alumini , i cili lidhet me qoshet e aluminit . Anët e konstruksionit janë te mbyllura me panele izolimi termik dhe akustik . Në strukturë janë inkorporuar të gjitha elementet per trajtimin e ajrit . Prurja e ajrit Q= 2948 m<sup>3</sup>/h . Seksioni i rekuperimit 80 % me rryma te kunderta . Seksioni i filtrimit : Filter G4 ( Hyrje dhe Dalje) , Filter F7 ne hyrje . Bateri uji ftohje/ngrohje 9/11 kW. Presioni në dergim 350 Pa dhe kthim 350 Pa. Gjenerator avulli 20 kg/h (16 kW). Dimensionet 1600x1100x4810 mm . Montimi , testimi dhe dorëzimi sipas përshkrimit në projekt , specifikimeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesit.</p>			
9	<p>Njesi e trajtimit të ajrit AHU 03 : Konstruksioni perbëhet nga profil special alumini , i cili lidhet me qoshet e aluminit . Anët e</p>			

	<p>konstruksionit janë te mbyllura me panele izolimi termik dhe akustik . Në strukturë janë inkorporuar të gjitha elementet per trajtimin e ajrit . Prurja e ajrit Q= 15844 m<sup>3</sup>/h . Seksioni i rekuperimit 80 % me rryma te kunderta . Seksioni i filtrimit : Filter G4 ( Hyrje dhe Dalje) , Filter F7 ne hyrje . Bateri uji ftohje/ngrohje 48/63 kW. Presioni në dergim 350 Pa dhe kthim 350 Pa. Gjenerator avulli 102 kg/h(2*35 kW). Dimensionet 2700x1220x5680 mm . Montimi , testimi dhe dorëzimi sipas përshkrimit në projekt , specifikimeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesit.</p>			
10	<p>Njesi e trajtimit të ajrit AHU 05 : Konstruksioni perbëhet nga profil special alumini , i cili lidhet me qoshet e aluminit . Anët e konstruksionit janë te mbyllura me panele izolimi termik dhe akustik . Në strukturë janë inkorporuar të gjitha elementet per trajtimin e ajrit . Prurja e ajrit Q= 19538 m<sup>3</sup>/h . Seksioni i rekuperimit 80 % me rryma te kunderta . Seksioni i filtrimit : Filter G4 ( Hyrje dhe Dalje) , Filter F7 ne hyrje . Bateri uji ftohje/ngrohje 58/79 kW. Presioni në dergim 350 Pa dhe kthim 350 Pa. Gjenerator avulli 126 kg/h (2*45 kW). Dimensionet 2700x1220x5680 mm . Montimi , testimi dhe dorëzimi sipas përshkrimit në projekt , specifikimeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesit.</p>			
11	<p>Njesi e trajtimit të ajrit AHU 06 : Konstruksioni perbëhet nga profil special alumini , i cili lidhet me qoshet e aluminit . Anët e</p>			

	<p>konstruksionit janë te mbyllura me panele izolimi termik dhe akustik . Në strukturë janë inkorporuar të gjitha elementet per trajtimin e ajrit . Prurja e ajrit <math>Q= 16134 \text{ m}^3/\text{h}</math> . Seksioni i rekuperimit 80 % me rryma te kunderta . Seksioni i filtrimit : Filter G4 ( Hyrje dhe Dalje) , Filter F7 ne hyrje . Bateri uji ftohje/ngrohje 51/68 kW. Presioni në dergim 350 Pa dhe kthim 350 Pa. Gjenerator avulli 110 kg/h(2*35 kW). Dimensionet 2700x1220x5680 mm . Montimi , testimi dhe dorëzimi sipas përshkrimit në projekt , specifikimeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesit.</p>			
12	<p>Pompe termike për ujë të ngrohtë sanitar  Kapaciteti nominal i ngrohjes: 48 kW  Diapazoni i temperaturës së funksionimit  Ftohje: -15 up to +48 °C  Ngrohje: -25 up to +43 °C</p>			
13	<p>Ashensor me karakteristika:  Lloji i ashensorit: pasagjerë dhe mallra  Lloji: elektrike, më dhomën e makinerisë (MRL-Machine Room Less)  Kapaciteti: <math>Q=1050 \text{ kg}</math> ; 14 persona  Shpejtësia: <math>v = 1,00 \text{ m/s}</math>  Numri i ndalesave: 5 (B+P+3)  Lloji i komandës: Mikroprocesor, lart-poshtë  Lartësia e boshtit: <math>H = 24,90 \text{ m}</math>  Makina e drejtimit + Paneli i kontrollit: lart, në hapësirën e kokës  Montimi, testimi dhe furnizimi siç përshkruhet në projekt, specifikim teknik dhe rekomandimet e Prodhuësit.</p>			

14	<p>Ashensor me karakteristika:  Lloji i ashensorit: pasagjerë dhe mallra  Lloji: elektrike, më dhomën e makinerisë (MRL)  Kapaciteti: Q=450 kg ; 6 persona  Shpejtësia: v = 1,00 m/s  Numri i ndalesave: 5 (B+P+3)  Lloji i komandës: Mikroprocesor, lart-poshtë  Lartësia e boshtit: H = 24,90 m  Makina e drejtimit + Paneli i kontrollit: lart, në hapësirën e kokës  Montimi, testimi dhe furnizimi siç përshkruhet në projekt, specifikim teknik dhe rekomandimet e Prodhuesit.</p>			
15	<p>Kompleti i pompës zjarfikëse sipas EN12845 i përbërë nga: - 1 pompë elektrike kryesore 1x18,5 kW Pompë centrifugale horizontale njëfazore me thithje aksiale, portë shkarkimi radial dhe konstruksion me tërheqje mbrapa. Me performancë sipas ISO 9906:2012 - Grada 3B - 1 Motorpompë me rezervë motori me djegie të brendshme 1x 18.5 kW sipas ISO 3046 (10.9.1) ku secili jep Q=66.84 m3/h; H=51,13 m; - Pompë pilot "Jockey" 1x1.1 kW, komplet i kompletuar me panel kontrolli dhe ndërprerës presioni për çdo pompë. Kompleti i provës me Flowmeter, enë zgjerimi për pompën pilot. Në anën e dorëzimit, nyje kundër vibrimit. Pompa - 2 copë, valvola - 2 copë, valvola moskthimi - 2 copë, kolektori i dërgesës DN80. Rezervuari i karburantit dizel për 6 orë pavarësi pune me frenim të rrjedhjeve.</p>			



**2.3.11.a** Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.11, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim (i dedikuar për këtë procedurë prokurimi) nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje në këtë procedurë prokurimi. Për rastin kur autorizimi është lëshuar nga distributori i autorizuar, ai duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin e autorizuar.

**2.3.11.b** Të paraqiten katalogët për të gjitha pajisjet sipas pikës 2.3.11. Katalogët duhet të paraqiten në formë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al). Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të verdhë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje. *Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Në preventivin e punimeve ka një numër të madh zërash që janë furnizim vendosje pajisje dhe nisur nga pesha specifike si në sasi dhe në vlerë që këto zëra zënë në preventive. AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e pajisjeve për nga vetë rëndësia që ka ky objekt. Kërkesa e këtij dokumenti që në këtë fazë krijon një lehtësi për Autoritetin Kontraktor pasi në këtë mënyrë siguron cilësinë, specifikimet teknike të këtyre pajisjeve e cila është lehtësisht e kontrollueshme gjatë fazës së zbatimit në referencë me dokumentat e paraqitura që gjatë kualifikimit. Nepermjet dorëzimit të këtij dokumentacioni që në fazën e vlerësimit asnjë OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimit që gjatë zbatimit të furnizojë të njëjtin mall të certifikuar nga KVO.

Kjo kërkesë është kërkuar që të sigurojë Autoritetin Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësisia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, është gjykuar të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar

brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në menyre të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshjeangazhimi, kataloge, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotesimi i kërkesës me siper garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

**2.3.12** OE merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite). Për këtë të paraqitet vetëdeklarim.

### *Njësia e Prokurimit*